





TAF KOLECI-SEKRETAR I PËRGJITHSHËM I FSPISH-S

F.S.P.I.SH.

SË BASHKU PËR NJË TË ARDHME TË SIGURTË!

PAK HISTORIK...

Në Shqipëri, sindikatat janë themeluar në vitin 1945 fill pas krijimit të Partisë Komuniste Shqiptare. Krijimi i lëvizjes sindikale ishte e lidhur ngushtë me ideologjinë komuniste të asaj kohe, në themel të së cilës ishte shembja e shoqërisë kapitaliste dhe ndërtimi i një ekonomie të planifikuar ku klasës punëtore i jepej (të paktën parimisht) fuqi politike dhe vetvendosjeje.



Me gjithë propagandën e kohës, roli i sindikatave gjatë periudhës komuniste në Shqipëri ka qënë kryesisht fiktiv, pasiv dhe nën kontrollin e plotë të shtetit komunist. Deri në vitin 1957 ekzistonin sindikata të ndara për sektorë të ndryshëm të ekonomisë, më pas u realizua dhe bashkimi i sindikatave në një organizatë të vetme që u quajt Bashkimet Profesionale Shqiptare (BPSH), e cila përfshinte pothuajse të gjithë klasën punëtore shqiptare të asaj kohe. Rënia e regjimit komunist në 1991 solli ndryshime rrënjësore politike, sociale dhe ekonomike në vend.

Shqipëria u transformua nga një vend me ekonomi të centralizuar, në një vend me ekonomi të lirë të tregut të punës, transformim që solli dhe marrëdhënie të reja dhe më intensive midis punëdhënësve dhe punëmarrësve. Viti 1991 çoi dhe në transformimin e lëvizjes sindikale në Shqipëri. Në vitin 1991 u krijua dhe sindikata e parë e minatorëve.

Sot, ka rreth 83 sindikata të themeluara në Shqipëri. Ato veprojnë kryesisht nën ombrellën e të dy konfederatave: Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë (KSSH) dhe Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë (BSPSH), të cilat përfaqësojnë së bashku rreth 90% të anëtarëve të sindikatave në Shqipëri, ndërsa pjesa tjetër funksionon në mënyrë të pavarur. Sektorët kryesorë ku veprojnë këto dy konfederata janë: arsimi dhe shkenca, administrata, pensionet, industria, bujqësia, industria ushqimore, shëndeti publik, transporti, nafta, ndërtimi, industria tekstile, zëjtaria, tregtia, metalurgjia dhe telekomunikacioni. Edhe pse sindikatat vitet e fundit kanë përjetuar një rritje të anëtarësisë në veçanti në sektorin publik dhe ndërmarrjet private (ndërmarrjet ish-shtetërore), përfaqësimi në sektorin privat është ende shumë i ulët.

(Kërkime gjeografike)



NDËR VITE...



GREVA E URISË SË MINATORËVE TË BULQIZËS

Minatorët e Bulqizës të kryesuar nga KSSH dhe FSPISH, vendosën të hynin në grevë urie, pas 22 ditë protestash. Ata ishin të vendosur se nuk do ta ndërprisnin as grevën dhe as protestën, nëse kërkesat e tyre nuk do të plotësoheshin”.

Greva nisi me kërkesën për rritjen e pagave 20 %, për rritjen e sigurisë në punë dhe për investime modernizuese të premtuara nga kompania koncensionare ACR.

Greva e urisë zgjati disa javë për shkak të mospajtimeve mes drejtuesve sindikalistë dhe kompanisë, duke shprehur mosbesim ndaj premtimeve të reja të kompanisë. Kjo ka qenë greva më e madhe e të gjitha kohërave në Shqipëri, për vetë faktin që kjo grevë po bëhej në galeritë nëntokë, në 1400 m në nëntokë.

Minatorët sindikalistë të kryesuar nga KSSH dhe FSPISH u qëndruan deri në fund kërkesave të drejta të tyre. Edhe pas shumë përpjekjesh nga ana e qeverisë për ta ndaluar grevën e urisë së minatorëve të Bulqizës, duke përdorur forcat e policisë, nuk ia kanë arritur qëllimit të tyre. Kjo grevë ka qenë dhe do të mbetet një fener i ndezur për të gjithë minatorët që rrezikuan jetën, në mbrojtje të të drejtës dhe dinjitetit të çdo minatori.



Protestë e metalurgëve në kompaninë “KURUM”

Protesta ka nisur që më datë 3 gusht të 2010s dhe shkak u bë dhuna e ushtruar nga drejtuesit të kompanisë ndaj punëtorëve shqiptarë. Drejtuesit e kompanisë “Kurum” kanë rënë dakord për disa kërkesa të paraqitura nga metalurgët. Gjatë marrëveshjes sindikalistët e FSPISH kanë arritur që të largojnë tre punonjësit turq, që ushtronin dhunë mbi punëtorët. Ndërkohë, është arritur që të plotësohen edhe kërkesat e tjera me karakter ekonomik. Pagat e punëtorëve përfituan një rritje prej 17% për pagat e ulëta dhe 10% për të lartat. “Kurum” bëri të mundur edhe dhënien e antidotit me një vlerë prej 200 lekësh të reja në ditë. Efekti financiar i rritjes së pagave filloi që nga 1 qershori i 2010-ës, ku kompania “Kurum” pagoi edhe shtesat që prej kësaj date. Por edhe nga ana institucionale u bënë ndryshime në favor të punëtorëve, pasi u ngrit një komision i përbashkët disipline nga shoqëria dhe sindikata FSPISH.

NE JEMI **FSPISH**



SË BASHKU PËR NJË TË ARDHME TË SIGURTË !

FSPISH si një organizatë e të gjithë punëtorëve. Për të ndryshuar Shqipërinë gjatë këtyre viteve ka bërë ndryshime rrënjësore në të gjithë punën organizuese dhe drejtuese të saj.

Këtë e ka arritur nëpërmjet zhvillimeve institucionale brenda organizatës si dhe në saj të një menaxhimi dhe zhvillimi serioz të gjitha resurseve njerëzore dhe ekonomike që disponon, organizon dhe drejton me sukses drejt një sindikate të shekullit të 21, drejt një sindikate europiane me dimensione sociale.

Reformimi dhe demokratizimi në formë dhe në përmbajtje i Statuteve, rregulloreve dhe marrëveshjeve tona mes kolegësh apo epror-vartës që ndërmoi Federata Sindikatave të Punonjësve të Industrisë së Shqipërisë, ka bërë që të jetë Federata më e organizuar në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

FSPISH është anëtare e Konfederatës së Sindikatave të Shqipërisë (KSSH).



FSPISH përfshin pesë sindikata profesioni si më poshtë vijon:

- *Sindikata e Energjisë (prodhim, shpërndarje dhe transmetim)*
- *Sindikata e Minierave*
- *Sindikata e Metalurgjisë*
- *Sindikata e Rrymave të dobëta dhe mekanika*
- *Sindikata e Naftës*

SË BASHKU PËR NJË TË ARDHME TË SIGURTË!

Lëvizja sindikaliste ecën krah për krah me zhvillimin e një vendi. Ajo shërben si kriter për matjen e këtij zhvillimi.

Varfëria, ndryshimet e mëdha shoqërore dhe politike, të gjitha këto të shoqëruara me lëvizjet demografike të popullsisë, janë faktorë që u vijnë në ndihmë punëdhënësve dhe u shërbejnë atyre për të ushtruar presion mbi punonjësit.

Punëdhënësit mundën dhe ata korruptojnë shumë njerëz në pozita të rëndësishme në mënyrë që të rrisin përfitimet e tyre.

Ne nuk shfaqemi atëherë kur punonjësi nuk ka zgjidhje, ne jemi aty me ta gjithë kohën, ne jemi punonjësit!

Sindikatat tona janë aktive, por ne përballemi me shumë presion nga punëdhënësit dhe nga njerëz të korruptuar që gjenden kudo.

ÇFARË SYNON FSPISH:



- Të garantojë punë të denjë për çdo të punësuar në Republikën e Shqipërisë.
- Të mbrojë sindikalistët nga veprimet burokratike të punëdhënësve.
- Të garantojmë mbrojtjen e të drejtave të punonjësve migrantë dhe emigrantë.
- Të mbështesë të drejtat e punëtorëve të rinj.
- Të garantojë integrimin e plotë të grave në organizatat sindikale.
- Të forcojë solidaritetin ndërkombëtar me sindikatat e vendeve të ndryshme të Europës.
- Të sigurojë solidaritet dhe asistencë për sindikatat e profesioneve dhe për çdo anëtar apo sindikalist pjesë të saj.

- FSPISH përfaqëson ruajtjen e interesave shoqërore, ekonomike e sociale të anëtarëve të saj dhe të çdo qytetari në përgjithësi, si individualisht ashtu edhe në mënyrë kolektive, me qëllim arritjen e standardeve optimale të punës, mirëqënies sociale dhe më gjërë në çdo sferë të jetesës.
- FSPISH është një organizatë sindikale që mbron interesat e punonjësve të Industrisë, si punonjësve të energjisë, minierave dhe kimi- metalurgjisë.
- FSPISH siguron të gjithë punëtorët shqiptarë, se si anëtare e Këshillit Kombëtar të Punës në Republikën e Shqipërisë (KKP), është gjithmonë në gatishmëri, për të mbrojtur interesat e tyre në nivel kombëtar.



Ndërtimi i strukturave sindikaliste në çdo kompani, ku FSPISH ka kontratë kolektive, ka qënë dhe është një nga pikat më të forta. Në çdo kompani të zgjedhurit në krye të sindikatës, janë punonjës shumë të ndërgjegjshëm, duke bërë kështu që zëri i punonjësve të jetë prezent kudo dhe kërkesave e drejta të tyre t'u jepet zgjidhje sa më efikase. Në çdo kompani FSPISH ka kryetarët, nënkryetarët, sekretarët, përfaqësues të rinisë dhe të gruas, ku bejnë të mundur qe çdo problem apo kërkesë e anëtarëve tanë të jetë në qendër të diskutimit dhe dialogut në tavolinat e bisedimeve.

Punonjësit në kompanitë ku FSPISH ka kontrata Kolektive u mundësohet asistencë juridike falas për raste të ndryshme ku çështja nuk arrin të zgjidhet me dialog ndërmjet punëdhënësit dhe punëmarrësit, duke i siguruar punonjësit mbështetje morale dhe ligjore deri në zgjidhje të rastit.

Të tjera fusha shumë të rëndësishme janë dhe trajnimi sindikal i anëtarëve të FSPISHs. Çdo vit dy grupe me nga 30 sindikalistë bëjnë trajnime të ndryshme jashtë vendit, ku kjo i mundësohet nga sindikatat simotra ndërkombëtare, ku FSPISH është anëtare me të drejta të plota dhe ka marrëveshje bashkëpunimi. Të tjera seminare brenda Shqipërisë me tematika të ndryshme ku gjithmonë është primare njohja dhe aftësimi sindikal, gjithashtu dhe tematikave të tjera ku përfshihen njohja me legjislacionet përkatëse të punës, gjithashtu dhe konventave të ndryshme të ILOs të ratifikuara nga shteti Shqiptar.

SË BASHKU PËR NJË TË ARDHME TË SIGURTË!

FSPISH sheh si prioritet përmirësimin e kushteve në punë, siguria dhe shëndeti në punë për çdo punonjës në kompanitë ku ka kontrata kolektive dhe interesave të punonjësve në përgjithësi në çdo kompani. Ne kujdesemi që asnjë punonjës të mos jetë i pambuluar nga kontrata kolektive dhe zbatimin me rigorozitet të mbrojtjes dhe benefiteve që rrjedhin prej saj. Përfitimet që rrjedhin nga kontrata kolektive janë të ligjshme juridikisht dhe siguron që çdo kërkesë mbështetet në Kodin e Punës apo në legjislacionin përkatës për punën.



I kemi mëshuar me vendosmëri një tranzicioni të drejtë, ku punonjësit po përballen me ndryshime të ndryshme teknologjike. Në këto kompani ku industria 4.0 është tashmë prezente, ne sigurohemi që ndryshimet teknologjike mos të jenë në dëm të punonjësit, por të jenë në ndihmë të tij, duke bërë kështu që tranzicioni të jetë i duhuri dhe sa më i drejtë. Kjo bëhet e mundur nëpërmjet aftësimimit dhe trajnimit të punonjësve për pozicione të ndryshme teknologjike, ku është e domosdoshme. Mbrojtja dhe promovimi i vlerave njerëzore, barazia gjinore si dhe paga dinjitoze për një jetë sa më dinjitoze dhe mirëqenie, është ajo ç'ka FSPISH ka vënë prioritet dhe i përmbahet me shumë përpikmëri.